

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”
FAKULTETI I FILOLOGJISË
DEGA E GJUHËS SHQIPE



MA Manjola Lubishtani

**MARKERËT ORGANIZUES NË TIPA TË
NDRYSHËM TË TEKSTIT NË GJUHËN
SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Prishtinë, 2022

UNIVERSITY OF PRISHTINA “HASAN PRISHTINA”
FACULTY OF PHILOLOGY
DEPARTMENT OF ALBANIAN LANGUAGE



MA Manjola Lubishtani

**ORGANIZATIONAL MARKERS IN
DIFFERENT TYPES OF TEXTS IN ALBANIAN
LANGUAGE**

DOCTORAL THESIS

Prishtina, 2022

UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”

FAKULTETI I FILOLOGJISË
DEGA E GJUHËS SHQIPE



MA MANJOLA LUBISHTANI

**MARKERËT ORGANIZUES NË TIPAT E
NDRYSHËM TË TEKSTIT NË GJUHËN
SHQIPE**

PUNIMI I DOKTORATËS

Mentori:

Prof. dr. Bardh Rugova

Prishtinë, 2022

Përmbledhje

Markerët e Diskursit janë cilësuar si njësi themelore si për kuptimin, ashtu dhe për prodhimin e tekstit, meqë determinojnë koherencën e, veçanërisht, kohezionin e diskursit. Nga ana funksionale ata bëjnë të mundur realizimin e kohezionit si organizues të ndërlidhjes logjiko-semantike të segmenteve përbërëse të tekstit dhe, njëkohësisht, shërbejnë si katalizatorë aktivë të koherencës tekstore duke garantuar kështu qëndrueshmërinë kuptimore brenda dhe jashtë planit lokal të çdo teksti.

Nisur nga këto veçori, studimi i markerëve të diskursit në këto tri dekadat e fundit ka ngjallur kërshërinë e mjaft studiuesve të rinj në fushën e analizës së diskursit dhe gjuhësisë së tekstit. Studimet e tilla kanë shënuar një rritje të vazhdueshme duke ofruar një bazë të dendur teorike, dhe jo vetëm, në gjuhë të ndryshme. Në hapësirën shqipfolëse, karakteristikë e së cilës është njohja dhe përdorimi i termit *konektor*, numri i studimeve që lidhen me këtë grup elementesh mjaft të rëndësishme në procesimin e një teksti, është ende simbolik. Kryesisht, studimet e ofruara nga autorët *Dibra & Varfi (1999)*, *Çeliku (2005)*, *Toska (2012)*, *Mëniku (2013)*, *Rugova & Sejdiu-Rugova (2015)* u janë referuar çështjeve të përzgjedhjes terminologjike, pra emërtimit të tyre në shqipen (Dibra & Varfi); rolit të tyre në vështrim përfaqësues si realizues të koneksionit eksplicit dhe formave metakomunikuese si realizuese të koneksionit implicit (Çeliku); klasifikimit semantik e morfologjik të tyre (Mëniku); përdorimit të tyre në tekstin argumentues, duke i analizuar në mënyrë përfaqësuese ndërmjet anglishtes dhe shqipes e duke nënvizuar në mënyrë specifike tiparet dalluese në planin lokal e global të tekstit si realizues të konektivitetit tekstual (Toska); funksionit të tyre si mjete të realizimit të kohezionit gramatikor dhe të shprehjes së marrëdhënieve logjiko-semantike (Rugova & Sejdiu -Rugova).

Pikërisht, hapësira që ofron ky vakum studimor dhe dëshira për të plotësuar e për të zgjeruar studimet në këtë fushë në domenin shqiptar na nxiti që të përzgjedhim e të fokusohemi në një grup markerësh që zënë një vend të rëndësishëm në korpusin e dendur të markerëve të diskursit si mjete të domosdoshme në strukturimin e informacionit dhe organizimin e tij. Pra, objekt kryesor të trajtimit në këtë punim kemi përzgjedhur markerët organizues dhe rolin që ata luajnë në strukturimin dhe ruajtjen e tërësisë së sekuencave si njësi të vetme komunikuese

(markerët renditës), si dhe funksionit që ata ushtrojnë në përmirësimin dhe sigurimin e vazhdimësisë së konektivitetit në diskurs (markerët riformulues).

Në morinë e klasifikimeve të ofruara nga një numër studiuesish, si: Schiffrin, Bazzanella, Blakemore, Fraser, Brinton, M. Zorraquino & Portolés, Ferrari, bazuar në këndvështrime të ndryshme në rrafshin logjik, semantik e pragmatik, ne kemi përzgjedhur klasifikimin që autorët J. Portolés e M. A. Zorraquino kanë pasqyruar në “Gramática descriptiva de la lengua española” (1999), në kreun “Las marcadores del discurso”. Meqë diversiteti konceptual lidhur me MD-të fillon që nga heterogjeniteti i terminologjisë emërtuese, ne jemi përcaktuar për emërtimin “markerë të diskursit” dhe jo “konektorë” apo “lidhëzorë” siç kanë zënë fill në traditën e re shqiptare, duke mbështetur pikëpamjet dhe argumentimet e një sërë studiuesish, kryesisht amerikanë e spanjollë.

Kështu, në këtë punim, sipas terminologjisë dhe kategorizimit të bërë nga M. A. Zorraquino e J. Portolés (1999), do të mbështesim e do të përdorim termin *marker i diskursit*, duke e përdorur si një hipernim të termit *konektor*, pra si një emërtim mbikategorial gjithëpërfshirës, meqë, siç do të argumentojmë më tej, termi *marker* përmbledh në vetvete disa kategori pragmatike: *strukturues informacioni*, *konektorë*, *riformulues*, *operatorë diskursivë* dhe *markerë konversacionalë (bashkëbisedues)*. Nga ky klasifikim ne kemi shkëputur dy kategori: **markerët renditës** (në radhë të parë, në rend të parë, së pari, nga njëra anë, para së gjithash, nga ana tjetër, së dyti, së treti, së fundmi, fare në fund, për ta përfunduar etj.), të cilët ndahen në tri nëngrupe dhe **markerët riformulues**, (domethënë, pra, më mirë, më saktë, shkurt, shkurtimisht, me pak fjalë, në çdo rast, gjithsesi, sidoqoftë, përfundimisht etj.), të cilët nëngrupohen në pesë lloje. Që të dyja kategoritë e përzgjedhura i kemi klasifikuar në një grup tipologjik funksional të titulluar “markerë organizues”.

Duke ofruar një pasqyrë të këndvështrimeve teorike, përfshirë këtu dhe analizën e dy teorive kryesore, asaj Argumentuese dhe asaj Relevante, do të argumentojmë reflektimin e veçorive individuale të markerëve renditës e riformulues, ambiguitetin e tyre, tiparet strukturuese dhe marrëdhëniet ndërmjet vetë llojit kategorial në tipa të ndryshëm të tekstit në gjuhën shqipe, sidomos në rrafshin krahasues, kryesisht ndërmjet teksteve narrative (te të cilat prania e këtyre markerëve është hipotetikiisht jo e dendur) dhe atyre argumentuese, të cilat karakterizohen nga frekuenca më e lartë e përdorimit të tyre.

Në këtë punim do të lëvrojmë shembuj autentikë të vjelë në mënyrë të digjitalizuar, një pjesë të konsiderueshme të tyre nga Korpusi Nacional i Gjuhës Shqipe, të cilët do të përbëjnë dy korpuse gjuhësore: i shkruar dhe i folur. Duke i analizuar në të dyja këto forma të diskursit,

besojmë se do të përftojme rezultate produktive për tipologjinë dhe funksionet pragmatike të markerëve të tillë në gjuhën shqipe.

Me anë të këtij studimi, synojmë që në një anë të kontribuojmë në një analizë më të thellë të këtij grupi markerësh brenda klasës së markerëve të diskursit, ndërsa, njëkohësisht, të krijojmë një bazë për analizë krahasuese të markerëve të diskursit që shtrihen edhe në nëntipa të tjerë të papërfshirë në këtë punim.

Punimi është konceptuar të paraprihet nga *hyrja*, e cila do të pasohet nga trajtimi i objektit të studimit, qëllimi dhe rëndësia e përzgjedhjes së temës për hulumtim, metodologjia e përdorur dhe struktura e tij.

Ky punim do të përbëhet nga pesë krerë. Dy të parët do të përmbledhin teoritë themelore të domosdoshme për analizën krahasuese të zhvilluar në krerët e fundit.

Në *kreun e parë* do të pasqyrojmë këndvështrimet teorike ekzistuese për markerët e diskursit, të cilat do të na shërbejnë për analizimin tipologjik e funksional të markerëve organizues. Edhe pse teoritë që trajtojnë këto nocione janë disa, ato grupohen në dy blloqe kryesore (Flores Akiña, 2003: 21): nga njëra anë pragmatika e traditës anglo-saksone (Teoria e Akteve të të folurit e J. Austin-it, Teoria Konversacionale e H. P. Grice dhe Teoria e Relevancës e D. Sperber & D. Wilson) dhe, nga ana tjetër, pragmatika e integruar e domenit frankofon (Teoria Argumentuese e O. Ducrot & J. C. Anscombe). Siç kemi theksuar më sipër, ne do të përqendrohemi në analizimin e Teorisë Argumentuese dhe Teorisë së Relevancës, të cilat do të na japin një pasqyrë të pasur të kuadrit teorik bazik.

Në *kreun e dytë* do të përqendrohemi në argumentimin teorik të konceptit për markerët e diskursit, duke iu referuar çështjeve që lidhen me heterogjenitetin e emërtimeve, domethënien, tiparet dhe klasifikimin e tyre. Këto tipare do të shpalosen gjatë analizimit të këndvështrimeve individuale të zërave më të fuqishqëm që kanë analizuar MD-të, si: M. Halliday & R. Hasan, T. V. Dijk, D. Schiffrin, G. Redeker, B. Fraser; C. Bazzanella, A. Ferrari, M. Palermo; J. Portolés Lazaro e M. A. Martin Zorraquino, duke argumentuar dhe përzgjedhjen e kategorizimit të MD-ve.

Në *kreun e tretë* do të analizojmë markerët organizues, duke shkëputur nga ky grup markerët strukturues (grup në të cilin kategorizohen markerët renditës), duke ofruar një analizë semantiko-pragmatike për çdo marker. Do të analizojmë për çdo nëngrup funksionet, marrëdhëniet dhe frekuencat me të cilat shfaqen në tekste të ndryshme: *rrëfyes (narrativ)*, *përshkrues*

(deskriptiv), argumentues, shpjegues (informativ) dhe udhëzues (rregullativ), si dhe nënlojet që përfshihen në çdo tip.

Kreu i katërt do të pasqyrojë një analizë të detajuar për markerët riformulues, duke evidentuar edhe për këtë nëngrup funksionet, marrëdhëniet dhe frekuencat me të cilat shfaqen në tekste të ndryshme. Po ashtu, një vend i rëndësishëm do t'u kushtohet dhe pozicioneve që zënë natyrshëm në sekuencë, si dhe lëvizjes pozicionale të tyre.

Kreu i pestë do të karakterizohet nga analiza dhe argumentimi i tipareve dhe i funksioneve pragmatike; po ashtu, edhe nga procesimi i vlerave të frekuencës dhe të dendurisë së përdorimit të këtyre markerëve në tipa të ndryshëm të tekstit, në një korpus të përzgjedhur në mënyrë rastësore, po me synimin për të përfshirë disa nga nëntipat e teksteve si në ligjërimin e folur, ashtu dhe në atë të shkruar. Kështu, do të analizojmë në mënyrë të detajuar praninë dhe frekuencat e markerëve renditës dhe atyre riformulues në çdo tip teksti (në një apo disa nga nënlojet e tij) e, më pas, do të krahasojmë vlerat e shfaqjes të tyre për të konstatuar dominancën e secilit lloj markeri e për të konkluduar, gjithashtu, tekstin që karakterizohet nga prania e natyrshme e markerëve organizues kundrejt tipit (a tipave) të tekstit, te i cili prania e tyre shënon vlera të ulëta ose mungon krejtësisht.

Punimi do të vazhdojë me *përfundimet*, të cilat do të ndiqen nga *bibliografia*, nga *lista e burimeve kryesore* të shfrytëzuara, si pjesë e korpusit të përzgjedhur, dhe nga *indeksi i emrave* e *indeksi i termave* të përdorur gjatë hulumtimit.

Fjalët kyç: *organizues të diskursit, markerë renditës, markerë riformulues, vlera semantike, funksione pragmatike, ligjërim i shkruar, ligjërim i folur*

Resume

Discourse markers are considered as basic units for both the meaning and the production of the text, as they determine the coherence and, in particular, the cohesion of the discourse. Functionally, they enable the realization of cohesion as organizers of the logical-semantic interconnection of the constituent segments of the text and, at the same time, serve as active catalysts of textual coherence, thus guaranteeing the semantic consistency inside and outside the local plan of each text.

Given these features, the study of discourse markers in the last three decades has aroused the curiosity of many young scholars in the field of discourse analysis and text linguistics. Such studies have marked a steady increase by providing a dense theoretical basis, and not only, in different languages. In the Albanian-speaking space, which is characterized by the knowledge and use of the term connector, the number of studies related to this group of very important elements in the processing of a text, is still symbolic. Mainly, the studies provided by the authors Dibra & Varfi (1999), Çeliku (2005), Toska (2012), Mëniku (2013), Rugova & Sejdiu-Rugova (2015) referred to the issues of terminological selection, i.e. their naming in Albanian (Dibra & Varfi); their role in the approach as implementers of explicit connection and metacommunication forms as implementers of implicit connection (Çeliku); their semantic and morphological classification (Mëniku); their use in the argumentative text, analyzing them comparatively between English and Albanian and specifically underlining the distinguishing features in the local and global text plan as implementers of textual connectivity (Toska); their function as tools for achieving grammatical cohesion and expressing logical-semantic relations (Rugova & Sejdiu-Rugova).

Precisely, the space offered by this study vacuum and the desire to complete and expand studies in this field in the Albanian domain prompted us to select and focus on a group of markers that occupy an important place in the dense corpus of discourse markers, as necessary tools in

structuring information and organizing it. So, the main object of treatment in this paper we have selected the organizational markers and the role they play in structuring and maintaining the entirety of the sequences as a single communication unit (ranking markers), as well as the function they exercise in improving and ensuring continuity of connectivity in discourse (reformulation markers).

In the multitude of classifications offered by a number of scholars, such as: Schiffrin, Bazzanella, Blakemore, Fraser, Brinton, M.A. Zorraquino & Portolés, Ferrari, based on different perspectives in the logical, semantic and pragmatic plane, we have selected the classification that the authors J. Portolés and M.A. Zorraquino have reflected in "Gramática descriptiva de la lengua española" (1999), in the chapter "Las marcadores del discurso". Since the conceptual diversity related to DMs starts from the heterogeneity of naming terminology, we are defined for naming "discourse markers" and not "connectors" as they originated in the new Albanian tradition, supporting the views and arguments of a range of scholars, mostly American and Spanish.

Thus, in this paper, according to the terminology and categorization made by M.A. Zorraquino and J. Portolés (1999), we will support and use the term marker of discourse, using it as a hypernation of the term connector, i.e. as a comprehensive supercategory name, since, as we will argue further, the term "marker" encompasses several pragmatic categories: information structuring, connectors, reformulation markers, discursive operators, and conversational markers. From this classification we have separated two categories: ordinative markers (*në radhë të parë, në rend të parë, së pari, nga njëra anë, para së gjithash, nga ana tjetër, së dyti, së treti, së fundmi, fare në fund, për ta përfunduar etj.*), which are divided into three subgroups, and reformulation markers (*domethënë, pra, më mirë, më saktë, shkurt, shkurtimisht, me pak fjalë, në çdo rast, gjithsesi, sidoqoftë, përfundimisht etj.*), which are subgrouped into five types. We have classified both selected categories in a functional typological group entitled "organizational markers".

Providing an overview of theoretical perspectives, including the analysis of the two main theories, Argumentative and Relevant, we will argue the reflection of the individual features of ranking and reformulation markers, their ambiguity, structural features and the relationship between categorical type in different types of texts in the Albanian language, especially in the comparative plane, mainly between narrative texts (in which the presence of these markers is hypothetically not dense) and argumentative ones, which are characterized by the highest frequency of their use.

In this paper we will present authentic examples collected in a digitalized way, a considerable part of them from the National Corpus of the Albanian Language, which will consist of two language corpora: written and spoken. By analyzing both of these forms of discourse, we believe that we will obtain productive results for the typology and pragmatic functions of such markers in the Albanian language.

Through this study, we aim on the one hand to contribute to a deeper analysis of this group of markers within the class of discourse markers, while, at the same time, to create a basis for comparative analysis of discourse markers that extend to other subtypes, that are not included in this paper.

The paper is conceived to be preceded by the introduction, which will be followed by the treatment of the object of study, the purpose and importance of selecting the topic for research, the methodology used and its structure.

This paper will consist of five chapters. The first two will summarize the basic theories necessary for comparative analysis developed in recent chapters.

In the first chapter we will reflect the existing theoretical perspectives on discourse markers, which will serve us for the typological and functional analysis of organizational markers. Although the theories dealing with these notions are few, they are grouped into two main blocks (Flores Aikuña, 2003: 21): on the one hand, the pragmatics of the Anglo-Saxon tradition (J. Austin's Theory of Speech Acts, Conversational Theory of H.P. Grice and the Theory of Relevance by D. Sperber & D. Wilson) and, on the other hand, the integrated pragmatics of the francophone domain (The Argumentative Theory of O. Ducrot & J.C. Anscombre). As we have pointed out above, we will focus on the analysis of Argumentation Theory and the Theory of Relevance, which will give us a rich overview of the basic theoretical framework.

In the second chapter we will focus on the theoretical argumentation of the concept of discourse markers, referring to issues related to the heterogeneity of denominations, their meaning, features and classification. These features will be revealed during the analysis of the individual perspectives of the most powerful voices analyzed by the DMs, such as: M. Halliday & R. Hasan, T. V. Dijk, D. Schiffrin, G. Redeker, B. Fraser; C. Bazzanella, A. Ferrari, M. Palermo; J. Portolés Lazaro and M. A. Martin Zorraquino, arguing and selecting the categorization of DMs.

In the third chapter we will analyze the organizational markers, separating from this group the structural markers (group in which the ranking markers are categorized), providing a semantic-

pragmatic analysis for each marker. We will analyze for each subgroup the functions, relationships and frequencies with which they appear in different texts: narrative, descriptive, argumentative, expository and instructive, as well as the subtypes included in each type .

The fourth chapter will reflect a detailed analysis of reformulation markers, highlighting for this subgroup the functions, relationships and frequencies with which they appear in different texts. Also, an important place will be devoted to the positions they naturally occupy in the sequence, as well as their positional movement.

The fifth chapter will be characterized by the analysis and argumentation of pragmatic features and functions; as well as by processing the frequency and density values of the use of these markers in different types of text, in a randomly selected corpus, with the aim of including some of the subtypes of texts as in spoken discourse, as well as in the written one. Thus, we will analyze in detail the presence and frequency of ranking and reformulation markers in each type of text (in one or some of its subtypes), and then we will compare their display values to ascertain the dominance of each type of marker and to conclude, also, the text that is characterized by the natural presence of organizational markers against the type (s) of text, in which their presence marks low values or is completely absent.

The paper will continue with the conclusions, which will be followed by the bibliography, the list of main sources used, as part of the selected corpus, and the index of names and index of terms used during the research.

Keywords: *discourse markers, ordinative markers, riformulation markers, semantic values, pragmatic functions, written discourse, oral discourse*